



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ____ prot

Tiranë më ____ . ____ . 2024

**VENDIM
Nr. 425, datë 30.07.2024**

**“PËR FILLIMIN E PROCEDURËS
SË PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, PËR POZICIONIN E LIRË
NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN
NR. 243, DATË 24.05.2023, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 8 dhe 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 24, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, bazuar në rezultatet e shortit për zgjedhjen e relatorit,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së për zgjedhjes për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 243, datë 24.05.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Caktimin e z. {...}, si relator për këtë procedurë për zgjedhjeje për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR